

## **KUSHTET E PËRGJITHËSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË CIVILE**

### **Neni 1**

#### **Dispozita të Përgjithëshme**

**“Kushtet e Sigurimit”**- do të quhen Kushtet e Përgjithëshme të Kontratës së Sigurimit për Përgjegjësinë Civile.

**“Siguruesi”**- do të quhet kompania e sigurimit Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group sha.

**“I Siguruari”**- do të quhet personi fizik ose juridik, interesi i të cilit mbulohet në sigurim sipas këtyre Kushteve të Sigurimit.

**“Polica e Sigurimit”**- do të quhet Kontrata e Sigurimit për Përgjegjësinë Civile e lidhur midis **Siguruesit** dhe të **Siguarit**.

### **Neni 2**

#### **Shtesë personash të siguruar**

Me kusht që të jetë kërkuar dhe të jetë specifikuar në policen e sigurimit, fjala **“I Siguruari”** mund të përfshijë edhe sa më poshtë:

**2.1** çdo drejtues ose ortak/aksioner i të Siguarit në cilësitë përkatëse të tij si i tillë.

**2.2** çdo person të punësuar nga i Siguruari sipas një kontrate shërbimi apo periudhe punësimi ose prove në cilësitë përkatëse të tij si i tillë.

**2.3** çdo zyrtar ose punonjës i organizatave sportive dhe shoqërore ose mbarevajtjeje të të Siguarit ose të shërbimit në rast zjarri ose shërbimeve të ambulancës në cilësitë përkatëse të tij.

Cdo palë e tretë që ka të drejtën ligjore të kërkojë dëmshpërblim për dëme të kryera nga i Siguruari në lidhje me çdo Ngjarje të Siguar do të konsiderohet **“Perfitues”**.

### **Neni 3**

#### **Marrëveshja e Sigurimit**

Duke iu referuar kushteve, kufizimeve, përjashtimeve dhe kushteve të tjera që përmban kjo policë dhe me kusht që I Siguruari të ketë paguar primin, Siguruesi bie dakord që të dëmshpërblejë të Siguarin për:

**3.1** të gjitha shumat për të cilat I Siguruari do të bëhet ligjërisht përgjegjës të paguajë për kompensim, dhe kostot e dëmeve dhe shpenzimeve në lidhje me ndonjë Ngjarje të Siguar për të cilën kjo Policë zbatohet, brenda limiteve të dëmshpërblimit, limiteve të poshtëshënuara dhe në lidhje me biznesin siç është përshkruar në Policë, përfshirë njësinë, të marrë ose dhënë me qera ose në pronësi të të Siguarit.

**3.2** të gjitha shpenzimet për mosmarrëveshjet, të kryera me miratimin paraprak me shkrim të Siguruesit në lidhje me ndonjë kërkesë për dëmshpërblim ndaj të Siguarit, kërkesë për të cilën zbatohet dëmshpërblimi i shprehur në këtë policë.

### **Neni 4**

#### **Ngjarje e Siguar**

Ngjarjet e mëposhtme janë të siguruar nga Siguruesi në qoftë se ato do të ndodhin gjatë Periudhës së Sigurimit të percaktuar në këtë policë dhe kur i Siguruari t’ia ketë njoftuar ato Siguruesit jo më vonë se 72 ore nga momenti i ndodhjes së tyre.

**4.1** Çdo lloj dëmi shëndetësor (përfshirë vdekjen ose sëmundjen) i çdo personi që konsiderohet si **“Perfitues”** në këtë policë.

**4.2** Dëmtim ose humbje fizike e çdo lloj pasurie reale, të kundshme ose të patundshme që zotërohet nga çdo person që konsiderohet **“Perfitues”** në këtë policë.

## **Neni 5**

### **Limiti i dëmshpërblimit**

- 5.1 Për çdo ngjarje** - Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme çdo perfituesit ose një numri perfituesish për çdo ngjarje, nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si Limiti i Dëmshpërblimit për Ngjarje.
- 5.2 Deme ne Seri** - Për të përcaktuar kufirin e përgjegjësisë së Siguruesit në lidhje me ngjarjet e siguruara, të gjitha humbjet e ngjashme, në masë dhe lloj, dhe të ndodhura në mënyrë të perseritur apo që kanë si fillese një ngjarje të caktuar do të konsiderohen si të ndodhura në një ngjarje të vetme.
- 5.3 Limiti agregat** - Përgjegjësia e Siguruesit për të gjitha kostot, kompensimet dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e ndodhura gjatë periudhës së sigurimit, nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në police si Limiti Agregat.  
Dëmshpërblimi për çdo ngjarje për përgjegjësinë në lidhje me ngarkimin ose shkarkimin nga/ose të një mjeti, karrocierie mjeti ose anije, hidroplani ose aeroplani, nuk duhet të kalojë shumën maksimale të përcaktuar në policen e sigurimit.

## **Neni 6**

### **Kufizimet territoriale/ Juridiksioni**

Territori i policës nënkupton Republikën e Shqipërisë. Dëmi duhet të ketë ndodhur brenda këtij territori dhe policia i nënshtrohet ligjit/juridiksionit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 7**

### **Përgjegjësi**

Kjo policë nuk do të zbatohet për:

- 7.1** përgjegjësinë në lidhje me dëmtimet trupore ose sëmundje të çdo personi sipas një kontrate punësimi ose marrje në provë me të Siguruarin, nëse një përgjegjësi e tillë ka lidhje me dëmtimet trupore ose sëmundjet që ndodhin përgjate kryerjes së punës,
- 7.2** çdo shërbim ose këshillë profesionale, shërbim ose trajtim i dhënë, i administruar ose neglizhuar nga i Siguruarit (përgjegjësia profesionale),
- 7.3** përgjegjësia për çdo humbje financiare që nuk vjen si rezultat i dëmtimeve materiale ose shëndetësore siç përcaktohet në Nenin 4.
- 7.4** çdo përgjegjësi e çfarëdo lloji natyre që shkaktohet, vjen ose ndikon, direkt ose indirekt nga ndotja e ajrit, ujit ose tokës.
- 7.5** përgjegjësia në lidhje me humbjen ose dëmtimin e pasurisë:
- 7.5.1** që i përket të Siguruarit
- 7.5.2** Përpunohet nga/ose është nën kujdesin, ruajtjen, kontrollin e të Siguruarit ose çdo personi tjetër të punësuar nga/ose që punon për të Siguruarin. Kur ky i fundit nuk është i siguruar nga ndonjë kontratë e vecante sigurimi.
- 7.6** Përgjegjësia për humbje ose dëmtime të pasurisë që rrjedhin nga zjarri, rrufeja ose eksplozioni në ambientet e të Siguruarit.
- 7.7** Detyrimet/përgjegjësitë kontraktuale që përfshijnë por nuk kufizohen në: Kërkesat për dëmshpërblim në lidhje me vonesën e realizimit ose ekzekutimit të kontratave që janë lidhur, penalitetet kontraktuale të çdo lloji apo natyre.
- 7.8** Përgjegjësia për dëmtime në punën ose në artikuj të prodhuar ose furnizuar nga I Siguruarit, (ose nga ndonjë palë e tretë në emër të të Siguruarit) që shkaktohen nga një shkak i brendshëm në prodhim ose në furnizim.
- 7.9** Cdo humbje, dëmtim, kosto apo shpenzime të çdo natyre, që direkt apo indirekt, shkaktohen apo vijnë/rrjedhin nga cdo akt terrorimi;

- 7.10** Përgjegësia në lidhje me ndonjë artikull ose mall të furnizuar, instaluar, montuar nga i Siguruari për qëllime aviacioni ose anijeje, kozmike ose industrisë së automobilave (përfshirë çdo lloj pjese këmbimi ose përbërëse)
- 7.11** Përgjegësia në lidhje me çdo ngjarje që vjen si rrjedhojë e një veprimi të qëllimshëm dhe të pandershëm ose neglizhence nga ana e të Siguararit dhe që duhej të parashikoheshin nga ana e të Siguararit duke marrë parasysh natyrën dhe rrethanat e këtij veprimi ose neglizhence.
- 7.12** Përgjegësia marrë përsipër nga i Siguruari sipas një kontrate pune ose ndonjë lloj tjetër marrëveshje, përveç rastit kur përgjegjësi të tilla do t'i jenë ngarkuar të Siguararit edhe në mungesë të kontratave ose marrëveshjeve të tjera.
- 7.13** Çdo përgjegjësi e çfarëdo natyre që direkt ose indirekt është shkaktuar nga/ose që rrjedh nga:
- 7.13.1** rrezatimi ose ndotje jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve bërthamore ose prej rrjedhjeve bërthamore ose djegia e karburanteve bërthamore.
- 7.13.2** asbestosi ose sëmundje të tjera që lidhen me të (përfshirë kancerin) që rrjedhin nga egzistenca, prodhimi, trajtimi, përpunimi, shitja, shpërndarja, magazinimi, depozitimi ose përdorimi i asbestit, dhe/ose produkteve që përmbajnë asbest.
- 7.13.3** Energjia Nukleare;
- 7.14** Përgjegësia për çdo pasojë të luftës, pushtimit, veprimeve të armiqve të jashtëm (në luftë ose jo), lufta civile, revolucionin, ndërhyrja ushtarake, vandalizmi ose sabotimi.
- 7.15** Përgjegësia e detyrueshme ndaj paleve të treta e Drejtuesve të automjeteve, Përgjegësia e aviacionit, Përgjegësia e Marines, Përgjegësia e Transportuesve të Mallrave
- 7.16** Ndotja graduale e çdo lloji
- 7.17** Përgjegësia për dëmtimin e mjedisit që mbulon dëmet ndaj çdo lloj specieve të mbrojtura dhe habitatit të mbrojtur (biodiversiteti)
- 7.18** Përgjegësia e kryqezuar
- 7.19** Demet nën efektin e fushave Elektromagnetike
- 7.20** Shkelja e patentave, të drejtat e pronësisë intelektuale, të drejtat e autorit, emrat e tregtisë, markat tregtare të dizajnit të regjistruar dhe shkelja e të drejtave personale
- 7.21** Krimi, besnikëri, tutor
- 7.22** Çdo lloj garancie ose garancie
- 7.23** Ndalimi, ndërprerja e biznesit, paaftesia paguese, falimenti dhe/ose fitimin e munguar
- 7.24** Gjobat, masat ndëshkuese

## **Neni 8**

### **Pagesa e Primit**

**8.1 Periudha e sigurimit** – I Siguruari është i detyruar të paguajë, tek Siguruesiprimin e caktuar në Policë. Në rastin e pagesave me keste kësti i parë duhet të paguhet në momentin e lëshimit të Policës. Çdo pagesa e primin, përfshirë dhe kestin e pare, duhet të vertetohet me dokument shkresor ndryshe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Sigurimi hyn në fuqi në orën 24<sup>oo</sup> të ditës së shënuar në policë, me kusht që të jetë paguar primin, në rast të kundërt hyn në fuqi në orën 24<sup>oo</sup> të ditës së kryerjes së pagesës.

Në rastet e pagesave me keste, Sigurimi mbetet i pezulluar deri në ditën e afatit të pagimit të primit apo kesteve të rradhes të percaktuar në kontratë por jo me shume se 15 dite nga kalimi i këtij afati.

Nëse pas kalimit të afatit 15 ditor nuk është bërë pagesa e primit të rradhes, Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit.

Nëse ka ndodhur demit dhe primin apo kestin e rradhes ka qene i papaguar, përfshirë rastin e periudhes se pezullimit të sigurimit, Siguruesi ka të drejtë të refuzojë totalisht shpërblimin e demit edhe nëse nuk ka njoftuar me pare për zgjidhjen e kontrates se sigurimit.

**8.2 Rregullimi i Primit** - Primi, është caktuar të jete i ndryshueshem në bazuar në elementët e rrethave perkatese. Primi do të parapaguhet në mënyre provizore në shumën që rrjedh nga llogaritjet në policë dhe rregullohet në fund të çdo periudhe sigurimi vjetor ose më të shkurtër të kontratës, sipas

ndryshimeve të ndodhura gjatë së njëjtës periudhë, në elementët e marrë si bazë për llogaritjen e primit duke mos ndryshuar primin minimal të përcaktuar në policë.

Për këtë qëllim brenda 60 ditëve nga fundi i cdo periudhe vjetore të sigurimit ose të një kohëzgjatje më të shkurtër të kontratës, I Siguruari duhet të njoftojë me shkrim Siguruesin për të dhënat e mëposhtme:

1. Ndryshime thelbësore të ndodhura gjatë periudhës së sigurimit që ndikojnë në vlerësimin e riskut të sigurimit.
2. Informacione të tjera mbi elementë të ndryshëm të shënuar në police që kanë ndryshuar ose pritet të ndryshojnë.

Nese do të kete diference në menyren e perlllogaritjes se primit, kjo diferencë duhet që të paguhet në 30 ditët e mëpasme pas njoftimit të Siguruesit. Nëse I Siguruari nuk kryen njoftimin e të dhënave të mësipërme në kohën e duhur (brenda limiteve kohore të përcaktuara) ose nuk paguan diferencën e primit brenda afatit 30 ditor, Sigurimi pezullohet deri në momentin e pageses së diferencës së primit. Siguruesi nuk është përgjegjës për pagesën e detyrues të ndodhura gjatë periudhës së pezullimit të mbulimit në sigurim pavarësisht nëse ka njoftuar apo jo për zgjidhjen e kontratës së sigurimit.

## **Neni 9**

### **Parashikimet dhe procedurat për kërkesat për dëmshpërblim**

- 9.1** I Siguruari do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të lehtësuar dëmtimet trupore, sëmundjet, humbjet ose dëmtimet pasurore, të cilat mund të shkaktojnë lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj police.
- 9.2** Çdo ngjarje, e cila do të sillte lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas policës, duhet t'i raportohet me shkrim Siguruesit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 48 ore nga ndodhja e ngjarjes. Asnjë korrigjim ose riparim nuk do të bëhet përderisa Siguruesi të bejë investigimin. I Siguruari duhet të japë njoftim të menjëhershëm për çdo ndjekje penale për plagosje fatale ose procedura civile në lidhje me ngjarjen, dhe do t'i dërgojë menjëherë Siguruesit të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me çështjen.
- 9.3** Asnjë pranim i përgjegjësisë, premtim ose pagesë nuk do të bëhet pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën sipas zgjidhjes së tij, të marrë përsipër dhe të drejtojë në emër të të Siguarit mbrojtjen dhe rregullimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim dhe të proçedojë me shpenzimet dhe në të mirën e tij çdo pretendim për dëmshpërblim ose dëme ndaj çdo personi tjetër dhe I Siguruari duhet të japë të gjithë informacionin dhe ndihmën e kërkuar.
- 9.4** Siguruesi mund t'i paguajë të Siguarit shumën maksimale të pagueshme sipas kësaj police në lidhje me çdo ngjarje ose çdo shumë më të vogël me të cilën mund të rregullohen pretendimet që lindin nga një ngjarje e tillë, dhe Siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi të mëvonshme në lidhje me atë ngjarje, me përjashtim të pagesës së kostos dhe shpenzimeve të mosmarrëveshjeve të shkaktuara më përprara këtyre pagesave.
- 9.5** Nëse në kohën e ndonjë ngjarjeje ose pretendimi për dëmshpërblim, egziston një policë tjetër për dëmshpërblim ose sigurim në favor të/ose, e ndikuar nga/ose në emër të të Siguarit, e zbatueshme në të tilla ngjarje, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës sipas kësaj police të dëmshpërblejë të Siguarin në lidhje me këtë ngjarje ose pretendim, me përjashtim të pjesës që tejkalon shumën e cila është e pagueshme sipas dëmshpërblimit ose sigurimit tjetër.

## **Neni 10**

### **Kushte të përgjithshme**

- 10.1** Kjo policë, shtojcat e poshtëshënuara, formulari dhe kushtet e vecanta do të lexohen së bashku si një kontratë, dhe çdo fjalë ose shprehje për të cilën është atribuar një kuptim i veçantë në çdo pjesë të kësaj police, formularit ose kushteve të veçanta, do të mbajë po atë kuptim kudo që shfaqet.

- 10.2** Nëse primi për këtë policë ka qene llogaritur sipas një vlerësimi të dhënë nga I Siguruari, ky do të mbajë shënime të sakta për gjithë detajet përkatese dhe do ta lejojë Siguruesin në çdo kohë të inspektojë, shënime të tilla dhe me mbarimin e çdo periudhe sigurimi, do t'i dërgojë Siguruesit gjendjen e saktë të rregulluar, kështu që për këtë periudhë do të llogaritet primi dhe diferenca e paguar nga i Siguruari si mbulim.
- 10.3** Siguruesi mundet në çdo kohë të arsyeshme të inspektojë çdo njësi dhe në çdo rast se konstaton ndonjë defekt ose rrezik të shtuar, Siguruesi mund të japë njoftim me shkrim të Siguararit për rastet kur e gjithë përgjegjësia e Siguruesit për arsye të defekteve dhe rreziqeve të tilla, do të pezullohet.
- 10.4** Nëse në një kohë të caktuar do të shfaqet materialisht dicka që do të ndikojë në rrezikun e siguruar, I Siguruari duhet, brenda 7 ditëve të japë njoftim me shkrim siguruesit. Mos dhënia e këtij njoftimi e perjashton Siguruesin nga detyrimi për pagesën e demshpërblimit.
- 10.5** Kontrolli dhe plotësimi i detyrueshem i kushteve, klauzolave e parashikimeve përsa ato lidhen me ndonjë gjë që duhet kryer ose plotësuar nga i Siguruari dhe vërtetësia e pohimeve të bëra prej tij në kërkesën për sigurim (e cila janë baza e kësaj kontrate) do të jenë kushte parësore për të kërkuar përgjegjësi nga Siguruesi.

## **Neni 11**

### **Periudha e dëmshpërblimit**

Periudha e mbulimit është një vit me të drejte rinovimi. Vetem sa I perket detyrimit për pagesën e primit nga I Siguruari, policia vazhdon të jetë e vlefshme dhe do të paguhet primi për periudhën vjetore pasuese nëse nuk ka ndonjë njoftim me shkrim për anulimin e saj. Përgjegjësia e Siguruesit për pagesën e demit lind vetem pas pagimit të primit apo kestit të rradhes.

## **Neni 12**

### **Dispozita të fundit**

- 12.1 Klauzola e përjashtimit të sulmeve kibernetike** - Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton përgjegjësinë nga sulmet kibernetike, i cili nënkupton çdo rrezik të humbjes financiare, ndërprerjes ose dëmtimit të reputacionit të një organizate nga një lloj dështimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit. Ky sigurim në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëmtime, përgjegjësi apo shpenzime të shkaktuara ose të ndikuara direkt ose indirekt që rrjedhin nga përdorimi si mjet për të shkaktuar dëm i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashesh, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi tjetër apo pajisje tjeter elektronike.
- 12.2 Klauzola e Sanksioneve** - Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutave të Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- 12.3 Klauzola sqaruese** - Palet bien dakort se në çdo rast, parashikimi në paragrafin e mesipër të këtij neni, referuar si "Klauzola e Sanksioneve" do të aplikohet sipas rasteve/parashikimeve të parashikuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara / Bashkimit Europian / Mbretërisë së Bashkuar / Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

### **12.4 Klauzola e përjashtimit të sëmundjeve ngjitëse**

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim për çdo dëm

qe lidhet me deme trupore (perfshire Stresin Emocional ose traumen mendore ose fobine), cdo lloj demesh ose humbjesh materiale, te cilat jane ose pretendohet te jene shkaktuar nga, te ndikuara nga ose ne cdo menyre te lidhura me:

Sindromen e fituar te imunitetit te ulur (SIDA/AIDS) ose agjenteve patologjik te tij ose hepatiti;

Semundjet ngjitese: Me semundje ngjitese do te kuptohet cdo semundeje, e cila mund te transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substanca ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:

substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe

- metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
- sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë